



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1100/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Alternativa, me seli në Gjakovë, paraqitur kundër Albi Ademaj, votues nga Komuna e Gjakovës, për shkak të fotografimit të votës për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunave, në seancën e panelit të mbajtur më datë 21.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Alternativa, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, me shenjën ZL.Anr.1100/2017 e datës 19.11.2017, ashtu që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në shumë prej 2,500.00 (dymjë e pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimin të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 19.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjektit politik "Alternativa", me seli në Gjakovë, me të cilën pretendon se votuesi Albi Ademaj më datë 19.11.2017, gjatë të ditës së votimit ka bërë shkelje ligjore duke publikuar votën në rrjetet sociale, pikërisht në profilin e tij me të cilën shihet vota në rubrikën e kandidatit për Kryetar Komune në Gjakovë. Parashtruesi i ankesës konsideron se është bërë shkelje e Ligjit 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dhe Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it Nr.02/2015.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), në përgjigje në ankesë të datës 21.11.2017, ka theksuar se, publikimi i votës në rrjetet sociale është përgjegjësi penale e personave që kanë bërë këtë shkelje dhe i takon prokurorisë së shtetit të merret me çështjen në fjalë. Më tej ka theksuar se AAK ka vepruar në baz të Ligjit Nr.11/2013 neni 3.3, 3.4 dhe 3,6 për thirrjen dhe lajmërimin e të gjitha strukturave dhe mbështetësve që ta respektojnë ligjin në fuqi dhe rregulloren e kodit të mirësjelljes.

Përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur lajmrimin publik të AAK-së për respektimin e e Kodit zgjedhor.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, në kuptim të nenit 117.3 të LZP-së gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se se votuesi Albi Ademaj, mbështetës i subjektit politik AAK, ka bërë shkelje ligjore duke publikuar fotografinë me votën e tij në rrjetet sociale, me mbishkrimin” Jam ardh prej Gjermanie vetëm për një vot, Urime Ardian Gjini” në të cilin shihet se ka përmbajtje të fushatës zgjedhore në ditën e heshtjes zgjedhore konkretisht me datë 19.11.2017, veprim ky që është në kundërshtim dhe me nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së e cila përcakton se: *“Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Pretendimet e subjektit politik AAK se publikimi i votës në rrjetet sociale është përgjegjësi penale e personave që kanë bërë këtë shkelje dhe i takon prokurorisë së shtetit të merret me çështjen në fjalë, këtë pretendim paneli e ka marrë parasysh por zhvillimi i procedurës penale, nuk është arsye që ankesa të mos shqyrtohet pasi PZAP është i kufizuar vetëm nëse ekziston shkelja e pretenduar, ndërkaq në këtë rast kemi të bëjmë me nenin 32.5 të LZP-së përcakton se: Subjektet politike mbahen përgjegjës për shkeljet e këtij Kodi të kryera nga anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat për rastet: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së AAK-së, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marra subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur më fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij ka mohuar shkeljet e supozuara dhe e njëjta nuk ka ofruar prova sipas nenit 32.6 të LZP-së.

Andaj, PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), është përgjegjëse për veprimet e saja pasi që ka shkelur nenin nenin 32.5 dhe 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku parashihet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.1100/2017 më datën 21.11.2017

Kryesuesja e Panelit
Hasan Shala



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.